

VENDIM
Nr. 40, datë 4.8.2016

PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT TË MBETUR, PËR DISA PROJEKTE TË MIRATUARA NË VITIN 2012, 2013, DHE ME CIKËL FINANCIMI 2014–2015, TË GRANTIT TË ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të mbetur, për disa projekte, për grantin e arsimit, të miratuara në vitin 2012 dhe 2013, nga Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, granti për arsimin, për vitin 2016, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e financimit të mbetur, për dy projekte me cikël financimi 2014–2015, për grantin e arsimit, nga Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, granti i arsimit, për vitin 2016, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1

**LISTA E DISA PROJEKTEVE TË MIRATUARA NË VITIN 2012 DHE 2013, QË
FINANCOHEN NGA GRANTI PËR ARSIMIN, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016**

Nr .	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Program i buxhetor	Vendimi/e t e KZHR-së	Vlera totale e kontratës (në lekë)	Vlera e realizuar deri në vitin 2015 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit/financimi në vitin 2016 (në lekë)
1	Bashkia Dibër	Rikonstruksion shkollë 9-vjeçare, fshati Dukagjin, Komuna Derjan, Mat	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	13,269,194	12,098,880	1,170,314
2	Bashkia Elbasan	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Polis, Gurshpate	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	16,932,504	13,106,085	3,826,419
3	Bashkia Fier	Rikonstruksion shkollë 9-vjeç., Ruzhdie, Komuna Ruzhdie, Fier	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	17,268,281	11,909,401	5,358,880
4	Bashkia Fier	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare fshati Ngjeqar, Komuna Kurjan	09230	nr. 4, datë 18.5.2012	48,443,858	38,780,251	9,663,607
5	Bashkia Mallakastër	Rikonstruksion shkollë 9-vjeç. fshati Visoke, Komuna Qendër	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	47,876,474	34,876,743	12,999,731
6	Bashkia Tiranë	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare Mihajas, Komuna Bërzhite	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	32,286,508	2,587,440	29,699,068
7	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion, shtesë anësore dykatëshe dhe palestër për shkollën e mesme të përgjithshme, Komuna Vaqarr	09230	nr. 4, datë 18.5.2012	31,801,747	25,580,062	6,221,685
8	Universiteti "A. Moisiu", Durrës	Ndërtim i godinës së re universitare	09450	nr. 4, datë 18.5.2012	255,000,000	164,218,671	90,781,329
9	Universiteti Politeknik	Shtesë godine, Universiteti Politeknik	09450	nr. 4, datë 18.5.2012	128,041,000	86,071,000	41,970,000

10	Bashkia Tepelenë	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Sinanaj, Komuna Lopez	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	46,180,118	36,492,918	9,687,200
11	Bashkia Kurbin	Ndërtim, shkollë e re 9-vjeçare Adriatik, Komuna Fushë-Kuqe	09120	nr. 4, datë 18.5.2012	40,556,063	39,983,036	573,027
12	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Lekas, Komuna Lekas	09120	nr. 4, datë 16.4.2013	7,940,766	5,940,766	2,000,000
		TOTALI			685,596,513	471,645,253	213,951,260

Shënim.

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit dhe “korrekton” vlerën e projektit, sipas vendimeve respektive të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në vitin 2012 dhe 2013. Vlera e kontratës vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

2. “Vlera e realizuar deri në vitin 2015” tregon vlerën e realizuar, akumulative, deri më 31.12.2015. Vlera e realizuar vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

3. “Vlera e financimit në vitin 2016”, tregon diferencën midis vlerës së kontratës dhe atë të realizuar deri në vitin 2015, sipas sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe e Sportit). Për këto projekte, vlera e mbetur e financimit në vitin 2016, përmbush detyrimin për financim, duke shlyer në masën 100% vlerën e kontratës për zbatimin e punimeve. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën 7821 prot., datë 2.8.2016.

Tabela 2

**LISTA E PROJEKTEVE ME CIKËL FINANCIMI 2014–2015, QË FINANCOHEN
NGA GRANTI I ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, FINANCIMI NË VITIN 2016**

Nr .	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Program i buxhetor	Vendimi/e t e KZHR-së	Vlera totale e kontratës (në lekë)	Vlera e realizuar deri në vitin 2015 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit/financimi në vitin 2016 (në lekë)
1	Bashkia Dibër	Projekti “Shkolla qendër komunitare”, ndërtimi i 4 terreneve sportive në 4 shkollat e qytetit Peshkopi	09120	nr. 6, datë 10.6.2014	31,174,406	15,174,406	16,000,000
2	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Gjoricë dhe ndërtim palestere	09120	nr. 6, datë 10.6.2014	46,940,796	39,117,330	7,823,466
		TOTALI			78,115,202	54,291,736	23,823,466

Shënim.

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe “korrekton” vlerën e projektit, sipas vendimeve respektive të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në vitin 2014. Vlera e kontratës vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

2. “Vlera e realizuar deri në vitin 2015” tregon vlerën e realizuar, akumulative, deri më 31.12.2015. Vlera e realizuar vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

3. “Vlera e financimit në vitin 2016” tregon diferencën midis vlerës së kontratës dhe atë të realizuar deri në vitin 2015, sipas sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe e Sportit). Për këto projekte, vlera e mbetur e financimit për vitin 2016, përmbush detyrimin për financim, duke shlyer në masën 100% vlerën e kontratës për zbatimin e punimeve. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën 7821 prot., datë 2.8.2016.